

VENDIM
Nr.586, datë 8.9.1998

**PËR MIRATIMIN E KOMPANISË ME TË CILËN DO TË KONTRAKTOHET NDËRTIMI I
HIDROCENTRALIT TË BUSHATIT DHE PROCEDURAT DERI NË LIDHJEN E
KONTRATËS**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të miratojë ofertën e kompanisë kineze HAINAN SIT për kontraktimin e ndërtimit të hidrocentralit të Bushatit.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik dhe të Tregtisë, të studiojë dhe analizojë efektivitetin për realizimin e këtij projekti, në kushtet aktuale të sistemit elektroenergjitik. Në bazë të studimit dhe të analizave që do të bëhen, ngarkohen ministrinë e sipërpërmendura të negociojnë me Palën kineze për financimin dhe realizimin e hidrocentralit të Bushatit.

3. Këshilli i rrethit të Shkodrës dhe KESH-i, në zbatim të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994 “Për shpronësimet për interes publik”, duke filluar nga muaji shtator 1998, të fillojnë përgatitjen e procedurave për shpronësimin e sipërfaqes ku do të ndërtohet hidrocentrali i Bushatit.

4. Ministria e Punëve të Jashtme të njoftojë, brenda muajit shtator 1998, Republikën e Malit të Zi për projektin e hidrocentralit të Bushatit.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.89, datë 19.2.1996 “Për miratimin e firmës me të cilën do të kontraktohet ndërtimi i hidrocentralit të Bushatit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano